



Nr. 05/ 5852 / 2019

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenin 5 paragrafi c të Ligjit të Arsimit në Komunitet të Republikës së Kosovës Ligji nr. 03/L-068 të datës 21 Maj 2008, **Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018 të datës 20.07.2018 (Normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm)**, Nenit 20 të Ligjit për Arsimin Fillor të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë 04/L-032 të datës 29.08.2011, UA mbi verifikimin e diplomave dhe dokumentacionit tjetër të lëshuara nga BPrAL me Nr. 3/2010 të datës 16.04.2010 dhe UA 17/2009 të datës 28.08.2009 (Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë).

Drejtoria Komunale e Arsimit shpallë:

K O N K U R S

Për pranimin e kuadrit arsimor për vitin shkollor 2019/2020 në shkollat e Komunës së Hani të Elezit

Nr.	Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita	Vend i lirë
1	SHFMU	"Ilaz Thaçi"	Hani i Elezit	1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane, me plotësim orëve në Paldenicë dhe Gorancë (16+3+3) 2. Një mësimdhënës/e për Histori me plotësim orëve në Paldenicë. 3. Një mësimdhënës/e për Kimi 16 orë.	Vend i lirë. Vend i lirë Zëvendësim deri sa të kthehet mësimdhënësja prej pushimit të lindjes.
			Paralelja-Seqishtë	1. Një mësimdhënës/e të mësimiit klasor	Me kohë të caktuar
4	SHML	Dardania	Hani i Elezit	1. Një mësimdhënës/se për matematikë 16 orë. 2. Një mësimdhënës/e për mësim zgjedhor: Nga fusha: Jeta dhe Puna. Lënda (Karrierë dhe ndërmarrësi).	Vend i lirë. Me kohë të caktuar.

I. Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë).
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat) duhet të jetë kopje e vërtetuar në Komunën e Hanit të Elezit jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i tjerat jo profesionale nuk shqyrtohen,

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimorë:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 të datës 10.07.2015 (Normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), si dhe akteve juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138). Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre Udhëzimeve Administrative nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

III. Për vendet e lira në institucione edukativo arsimore, kohëzgjatja e kontratës është me afat të caktuar, e cila do të definohet në kontratën e punës, por jo më gjatë se me datë 31.08.2018.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e Komunës së Hanit të Elezit.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes nga data **05.07.2019** deri më **19.07.2019** në gazetën zyrtare, tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e Komunës së Hanit të Elezit.

IV. Intervista për mësimdhënës

Për këto vende të punës, kandidatët do t'i nënshtrohen testit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Testi me shkrim mbahet më **25.07.2019 ora 10:00** ndërsa intervista me gojë mbahet më **26.07.2019** nga ora **ora 10:00**, vendi; zyra e takimeve në komunën e Hanit të Elezit.

Data: 04.07.2019

